



Prishtinë: 19.12.2008  
Kodi i ZRRE-së: V\_152\_2008  
Nr. i referencës: ERO/CPD\_D\_73\_02\_08

### Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke marrë parasysh:

1. Kompetencat e Zyrës së Rregullatorit për Energji të dhëna në nenin 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë
2. Dispozitat sipas Kapitullit 3, nenit 16 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
3. Dëshmitë dhe procedurat e paraqitura nga palët;
4. Vendimin e DMK-së në ZRRE: ERO/CPD\_D\_73\_02\_08 të datës 12.02.2008;
5. Parashtrimin e kundërshtimit të vendimit të DMK nga ana e konsumatorit, drejtuar Bordit të ZRRE-së me datë 14.03.2008;
6. Nenin 18 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë;

### Në mbledhjen e mbajtur më 19 dhjetor 2008 nxori këtë:

#### VENDIM

**REFUZOHET** ankesa e konsumatorit Faik Hamiti (shifra e konsumatorit DPR – 31472, DPR- 31473, DPR – 31474) nga Prishtina, kundër Vendimit të DMK për arsye të paraqitura në arsyetimin e këtij vendimi

#### Arsyetim

1. Konsumatori në ankesën e tij drejtuar KEK Sh.A – Divizionit të Furnizimit – Departamentit për Konsumatorë ka refuzuar parapagimin për RTK pasi që konsumatori posedon tre njehsorë ku shifrat e konsumatorëve për të tre njehsorët .
2. Me datë 21.01.2008, KEK Sh.A – Divizioni i Furnizimit – Departamentit për Konsumatorë e me numër të referencës DPR – CO1 – 09 në përgjigjen e tyre dhënë konsumatorit shpjegon se parapagimi për RTK është i bazuar në Urdhëresën Administrative të UNMIK – ut 2003/12 dhe se KEK Sh.A ka shpjeguar se: “çdo shtëpi, biznes, ndërmarrje apo institucion tjetër në Kosovë është i obliguar sipas ligjit që të paguajë parapagimin për RTK”.
3. Pas kësaj konsumatori me datë 04.02.2008 iu është drejtuar Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve duke e apeluar përgjigjen e KEK Sh.A të datës 21.01.2008 e me numër të referencës DPR – CO1 – 17 lidhur me parapagimin për RTK.
4. Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE duke analizuar të gjitha dëshmitë e paraqitura nga ana e konsumatorit dhe KEK Sh.A ka vërejtur se:
  - 4.1 Në bazë të nenit 20.4 të Ligjit Nr. 02/L-47 për Radiotelevizionin e Kosovës të gjitha subjektet fizike dhe juridike në territorin e Kosovës janë të obliguar të paguajnë parapagimin për transmetuesin publik. Si një subjekt i tillë do të konsiderohen njësitë të cilat kanë një faturë për rrymë apo ndonjë faturë tjetër publike.
  - 4.2 Sipas nenit 20.3 dhe 20.9 të Ligjit Nr. 02/L-47 të liruar nga obligimi i cekur me lartë, përfshihen banorët e vendbanimeve ose pjesët e vendbanimeve të Kosovës ku mungon sinjali cilësor televiziv i rrjetit tokësor, dhe familjet që janë përfshirë në listën e Ministrisë së



**ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI**  
**ENERGY REGULATORY OFFICE**  
**REGULATORNI URED ZA ENERGIJU**

Punës dhe të Mirëqenies Sociale si kategori e veçantë përfshirë edhe ato që janë nën asistencë sociale.

5. Me datë 14.03.2008 konsumatori ka parashtruar kundërshtimin e tij kundër vendimit të DMK-së në Bordin e ZRRE-së.

Bordi i ZRRE-së ka analizuar Vendimin e lëshuar nga DMK: **ERO/CPD\_D\_73\_02\_08** dhe ka konstatuar se vendimi është në pajtim me Rregullat e ZRRE-së dhe me kornizën ligjore në fuqi.

Apeluesi nuk ka ofruar ndonjë dëshmi shtesë kundër këtij Vendimi, andaj Bordi i ZRRE-së ka vendosur ta **refuzojë** konsumatorin për arsyet e paraqitura në vendimin e DMK të ZRRE-së.

**Këshillë juridike:** Kundër këtij Vendimi pala mund të iniciojë procedurë gjyqësore në Gjykatën Kompetente në Prishtinë brenda (14) ditëve nga pranimi i Vendimit ose shpalljes së Vendimit në faqen tonë elektronike, cilado që ndodhë e para.

Bordi i ZRRE-së

---

Dr. Ali Hamiti, kryesues

---

Theranda Beqiri, anëtare

---

Dr. Nysret Avdiu, anëtar